



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE  
INSPEKTORATI SHTETËROR I MBIKËQYRJES SË TREGUT

KARTELE SHOQËRUESE E PRAKTIKËS

Dërgues, IQ Nr.Prot. 49/2, Data 8.02.2023

Shkurtimi i lëndës Raporti përfundimtar

Për Trajtim nga:	
(Struktura të tjera të ngarkuara)	<u>Zg. J. Duplioni</u>
Me porosi:	<u>Z. Frokueni</u> të dorëzohet edhe të fel. parafundimtar

Afati:  normal (7ditë) |  Prioritet (3 ditë) |  Urgjent (brenda ditës) |  Pa afat/ për dijani |  
Tjetër \_\_\_ ditë

Data 01.03.22, Nr. Prot. 149/2,

Nënshkrimi: (TITULLARI)

Marrë në dorëzim: 01/03,

Nënshkrimi: [Signature]

Kalon për trajtim (Struktura): \_\_\_\_\_, Me porosinë: \_\_\_\_\_

Marrë në dorëzim: \_\_\_\_\_, Nënshkrimi: \_\_\_\_\_


Kalon për trajtim (Struktura): \_\_\_\_\_, Me porosinë: \_\_\_\_\_

Marrë në dorëzim: \_\_\_\_\_, Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

Kalon për trajtim (Struktura): \_\_\_\_\_, Me porosinë: \_\_\_\_\_

Trajtimi i materialit përfunduar më: \_\_\_\_\_,  
Trajtimi i materialit pranuar më: \_\_\_\_\_,  
Trajtimi i materialit pranuar më: \_\_\_\_\_,  
Trajtimi i materialit pranuar më: \_\_\_\_\_

Specialisti  
Eprori në shkallë hierarkike  
Eprori në shkallë hierarkike  
Eprori në shkallë hierarkike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRIA  
INSPEKTORATI QENDROR  
DREJTORIA E MBIKËQYRJES SË INSPEKTIMEVE, UDHËHEQJES METODOLOGJIKE DHE KOORDINIMIT

Nr. 49/2 prot.

Tiranë, më 25.02.2022

Lënda: Dërgohet Raporti Përfundimtar i Mbikëqyrjes së Veprimtarisë Inspektuese

**INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MBIKËQYRJES SË TREGUT**

**Rruga “Shyqyri Bërxolli”, nr. 65, Tiranë**

Inspektorati Qendror, në zbatim të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të VKM-së nr. 696, datë 16.08.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-Inspektimi”, si dhe të Urdhrit nr. 25, datë 10.08.2018, “Për Miratimin e Rregullores për Përcaktimin e Procedurës së Inspektimeve, si një Proces i Rregullt Administrativ”, realizoi mbikëqyrjen e veprimtarisë inspektuese, për Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2021.

Bashkëlidhur, po ju dërgojmë Raportin Përfundimtar të Mbikëqyrjes së ushtruar online, nëpërmjet sistemit “e-Inspektimi” për ISHMT, si dhe Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna, i cili duhet të ridërgohet i plotësuar nga ana Juaj brenda 30 ditëve nga marrja e tij.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin.

**INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM**


**SHKËLQIM HAJDARI**






## RAPORT PËRFUNDIMTAR MBIKËQYRJE

*Rezultatet e mbikëqyrjes online të Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut  
për periudhën Janar-Dhjetor 2021*

**Teuta Kukaj:**  Drejtor, *Drejtoria e Mbikëqyrjes së Inspektimeve,  
Udhëheqjes Metodologjike dhe Koordinimit*

**Alma Prendi:**  Drejtor, *Specialist i Mbikëqyrjes së Inspektimeve,  
Udhëheqjes Metodologjike dhe Koordinimit*

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Inspektorati Qendror, me qëllim verifikimin e zbatimit të procedurave gjatë kryerjes së veprimtarisë së inspektimit, ka realizuar mbikëqyrjen online nëpërmjet sistemit “*e-Inspektimi*”, si dhe mbikëqyrjen e dokumentacionit fizik të administruar, të veprimtarisë inspektuese të ISHMT-së, për përmirësimin e efektivitetit dhe përgjegjshmërisë së procedimit administrativ të inspektimit. Për sigurimin e zbatimit me korrektësi të kërkesave ligjore të ligjit për inspektimin dhe të ligjeve sektoriale nga ISHMT, Inspektorati Qendror mbikëqyri periudhën inspektuese Janar-Dhjetor 2021.

ISHMT, ushtron funksionet e saj në zbatim të VKM-së nr. 36, datë 20.1.2016, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e inspektoratit shtetëror të mbikëqyrjes së tregut”, si dhe dispozitave të tjera ligjore dhe nënligjore. ISHMT është i organizuar në nivel qendror dhe është përgjegjës për inspektimin e zbatimit të kërkesave të detyrueshme ligjore në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve, mbrojtjes së pronësisë industriale, garantimit të mbrojtjes dhe të respektimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, si dhe të inspektimit metrologjik, sipas legjislacionit për metrologjinë.

Një ndër qëllimet kryesore të inspektimeve të ushtruara nga Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT) është garantimi i sigurisë së produkteve për konsumatorët, të vendosura në treg dhe në shërbim/në përdorim, nëpërmjet aktiviteteve mbikëqyrëse sipas legjislacionit përkatës në fuqi. ISHMT, gjithashtu monitoron respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, si dhe të të drejtave të tjera sipas fushës së veprimtarisë institucionale.

Gjatë mbikëqyrjes së veprimtarisë inspektuese të ISHMT, u konstatua se:

ISHMT është përdorues i portalit unik “*e-Inspektimi*” dhe vazhdon të realizojë veprimtarinë inspektuese online, vetëm nëpërmjet pajisjeve portabel **laptop dhe jo nëpërmjet tabletave**, edhe pse pajisja me tableta e gjithë trupës inspektuese është realizuar që prej Nëntorit të vitit 2018, e cilësuar kjo gjetje edhe në raportin e vitit paraardhës.

***Observacion ISHMT:*** .....Përdorimi i tabletit kërkon që: dokumentet standarde të dërgohen tek subjekti dorazi ose dokumentet standarde të dërgohen tek subjekti me postë.....

*Ky observacion nuk pranohet. ISHMT është pajisur edhe me printer portabel, i cili lehtësisht lidhet me tabletin dhe nëpërmjet tij është i mundur printimi i dokumentacionit standard të inspektimit të mbajtur pranë subjektit nga trupa inspektuese.*

ISHMT ka **Program Vjetor të inspektimeve, për vitin 2021**, të hartuar në bazë të prioriteteve dhe kategorish subjektsh të ndara sipas këtyre prioriteteve, të miratuar nga autoriteti përgjegjës. Gjithashtu, Programi Vjetor është gjeneruar edhe në sistemin “e-Inspektimi”.

**Programet Mujore** janë hartuar me listë subjektsh inspektimi, me fushë veprimtarie të përcaktuar, e cila lidhet me tematikën/prioritetin e programit vjetor, por **nuk janë të hartuar me bazë risku**. Gjithashtu, **u konstatua mospërputhje e subjekteve** të programuara për inspektim sjellë me shkresë pranë Inspektoratit Qendror, krahasuar me subjektet e programuara të gjeneruara në sistem.

*Observacion ISHMT: Programi vjetor i inspektimeve dhe si rrjedhim edhe planet mujore të inspektimeve janë hartuar me fushë veprimtarie sepse ISHMT akoma nuk ka një bazë të konsoliduar të dhënash mbi të cilën të hartohet metodologjia e riskut.... Në përgjithësi subjektet si pjesë e planit të punës mujore që sillet në IQ për miratim, hidhen të gjitha në sistem, ndërsa numri faktik inspektimeve me atë të planifikuar mund të mos përputhen për arsye: të mosgjetyes së subjekteve të planifikuar; situata covid-19; mungesa në logjistikë; ankesave që adresohen pranë ISHMT që kanë një afat kohor të përcaktuar për trajtimin e tyre, etj.*

*Ky observacion nuk pranohet. ISHMT të hartojë metodologjinë e riskut për ato fusha veprimtarie për të cilat ka një bazë të konsiderueshme të dhënash, siç mund të jetë fusha e të drejtave të autorit dhe të drejtat të tjera të lidhura me to apo pronësia industriale, të cilat nuk janë fusha të reja. Lidhur me realizimin e planit mujor, mirëkuptojmë arsyetimin tuaj për pamundësinë e kryerjes së totalit të inspektimeve të planifikuara, por subjektet e programuara me shkresë të përputhen me subjektet e programuara në sistem.*

Inspektimet e ushtruara nga ISHMT janë kryer **me Autorizim**, por autorizimi **nuk njoftohet paraprakisht** subjektit të inspektimit përpara fillimit të veprimeve të inspektimit.

*Observacion ISHMT: Autorizimi i inspektimit nuk është njoftuar paraprakisht në përputhje me*

nenin 32, pika 2 të Ligjit nr. 10433/2011 “Për inspektimin në RSH” .....

*Ky observacion nuk pranohet. Mosnjoftimi paraprak i Autorizimit sipas germës a, të pikës 2, të ligjit për inspektimin, nuk mund të argumentojë realizimin pa njoftim të të gjitha inspektimeve të programuara, pasi vendimi i mosnjoftimit paraprak nuk motivohet për të gjitha fushat e veprimtarisë, objekt inspektimi nga ISHMT. Për këtë ISHMT të kategorizojë vetëm ato subjekte, për të cilat ekziston rreziku që njoftimi mund të pengojë kryerjen me efektivitet të inspektimit.*

**Procesverbali i Inspektimit**, përgjithësisht plotësohet në të gjitha fushat e tij, por ka raste kur **nuk detajohen gjetjet** apo të pasqyrohen të gjitha konstatimet e procedurës inspektuese.

**Çështjet e inspektimit**, në shumicën e rasteve **nuk kanë të ngarkuara dokumentet justifikuese** të marra gjatë procesit të inspektimit apo edhe **dokumente të dorëzuara nga subjekti**, për të cilat i është lënë afat në procesverbalin e inspektimit.

*Observacion ISHMT: Dokumentet justifikuese të marra nga subjekti i bashkëngjiten procedurave dhe janë të depozituara në protokollin e ISHMT-së, një pjesë e tyre janë të ngarkuara në sistem dhe në disa raste të tjera sasia e tyre voluminoze bënë të pamundur ngarkimin e tyre në sistem.*

*Ky observacion nuk pranohet. ISHMT të marrë masa për administrimin e të gjithë dokumentacionit, pjesë e procedimit të inspektimit, në sistemin “e-Inspektimi”.*

Në modulën “gjobat”, **nuk pasqyrohet ecuria e masës administrative** (ankimuar ose jo, papaguar/paguar, data e pagesës dhe kësti) nga personi përgjegjës.

*Observacion ISHMT: ISHMT ka filluar punën për pasqyrimin e ecurisë së gjobës që në muajin Maj 2021.....*

*Ky observacion nuk pranohet. Çështjet e cituara nga ana Juaj ISHMT-DQ-2021-001799; ISHMT-DQ-2021-001189 dhe ISHMT-DQ-2021-00806 nuk janë pjesë e çështjeve të mbikëqyrura nga IQ sipas aneksit bashkëngjitur këtij raporti. Konstatimi lidhur me mos pasqyrimin e ecurisë së masës administrative deri në pagesën e saj, i referohet çështjeve të mbikëqyrura me përzgjedhje rastësore dhe faktit që kjo gjetje mbizotëron në shumicën e këtyre dosjeve, për periudhën kur është*



*hartuar raporti paraprak i mbikëqyrjes.*

Në të gjitha dosjet e shqyrtuara, dokumentet e veprimtarisë inspektuese të gjeneruara në sistem **nuk janë të nënshkruara** nga kryeinspektori, inspektorët apo subjekti i inspektimit, duke qenë se veprimtaria inspektuese realizohet nëpërmjet laptopeve.

**Procedura inspektuese**, në shumicën e rasteve, **realizohet konform ligjit nr. 10433**, datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ligjeve sektoriale në fuqi.

Raporti në vijim, pasqyron në mënyrë më të detajuar të gjithë procesin e mbikëqyrjes online, rezultatet, konkluzionet dhe rekomandimet lidhur me procedurën e veprimtarisë së inspektimit të ushtruar nga ISHMT, me qëllim verifikimin e zbatueshmërisë së legjislacionit në fuqi.

## **METODOLOGJIA E PUNËS**

Mbikëqyrja e veprimtarisë inspektuese, për periudhën Janar-Dhjetor 2021, u zhvillua nëpërmjet sistemit online të inspektimit “*e-Inspektimi*”, si dhe dokumentacionit fizik të administruar pranë

IQ-së. Kjo mbikëqyrje u bazua në:

- ✓ Kontrollin e Programit Vjetor të Inspektimeve për vitin 2021;
- ✓ Kontrollin e Programeve Mujore të Inspektimeve;
- ✓ Përcaktimin e numrit vjetor të inspektimeve, brenda dhe jashtë programit;
- ✓ Kontrollin e dosjeve të inspektimit;
- ✓ Përcaktimin e numrit të masave administrative, gjobë.

Procedura e mbikëqyrjes së dosjeve të inspektimit u realizua me zgjedhje rastësore, për secilin inspektor çdo muaj. Në total u mbikëqyrën 18% e dosjeve të inspektimit. Dosjet e inspektimit të përzgjedhura për t’u mbikëqyrur pasqyrohen në aneksin bashkëngjitur këtij raporti.

Gjatë mbikëqyrjes online, u shqyrtua dokumentacioni përkatës i administruar në sistemin “*e-Inspektimi*”, përfshirë këtu: programin vjetor, programet mujore të inspektimit, autorizimi, listë verifikimet, procesverbali i inspektimit, vendimi i ndërmjetëm, vendimi përfundimtar, si dhe dokumente të tjera justifikuese të përdorura gjatë veprimtarisë inspektuese.

## ANALIZA

Raporti është hartuar në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit për inspektimin dhe kërkesave të ligjeve sektoriale, nëpërmjet një analize të detajuar të procedurës inspektuese dhe dokumentimit të veprimtarisë së inspektimit të ushtruar pranë subjekteve fizikë dhe juridikë, duke analizuar veprimtarinë inspektuese për fushën e inspektimit që mbulon ISHMT dhe duke pasqyruar problematikat e hasura.

Analiza është kryer duke krahasuar procedurat inspektuese të ndjekura nga ISHMT, në raport me zbatimin e ligjit për inspektimin dhe ligjet sektoriale, *ku u konstatua se në përgjithësi procedura e inspektimit është konform legjislacionit në fuqi.*

## BAZA LIGJORE

- Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimet në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr.10480, datë 17.11.2011, “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve jo ushqimore”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 35/2016, “Për të drejtën e autorit dhe të drejtave të lidhura me to”;
- Ligji nr. 9875, datë. 14.02.2008, “Për metrologjinë”, i ndryshuar<sup>1</sup>;
- Ligji nr. 126/2020 “Për metrologjinë”;
- Ligji nr. 10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9947, datë 07.07.2008, “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9902, datë 17.04.2008, “ Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10216, datë 21.01.2010, “Për detergjentet”;
- Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”;
- Ligji nr. 44/2015, “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- VKM nr. 696, datë 16.08.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-Inspektimi”;

<sup>1</sup> Procedura inspektuese për fushën e metrologjisë deri në muajin tetor është zhvilluar në bazë të këtij ligji dhe akteve nënligjore përkatëse. Në muajin nëntor e në vazhdim janë verifikuar kërkesat ligjore sipas ligjit të ri nr. 126/2020, “Për metrologjinë” dhe akteve të reja nënligjore.



- VKM nr. 36, datë 20.01.2016 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e inspektoratit shtetëror të mbikëqyrjes së tregut”;
- VKM nr. 669, datë 28.09.2011, “Për etiketimin dhe të dhënat e përbërësve për detergjentet”;
- VKM nr. 1351, datë 03.10.2008, “Për miratimin e rregullores për kërkesat, teknike dhe metrologjike, për instrumentet matëse, ligjërisht të kontrolluara”, i ndryshuar;
- VKM nr. 1352, datë 03.10.2008, “Për miratimin e rregullores për parapaketimet”;
- VKM nr. 443 datë 22.07.2021 “Për miratimin e rregullores për parapaketimet”;
- VKM nr. 1161, datë 13.08.2008, “Për miratimin e rregullores “Për shishet enë-matëse””;
- VKM nr. 349 datë 16.06.2021 “Për miratimin e rregullores për shishet enë matëse”;
- VKM nr. 770, datë 2.11.2016, “Për miratimin e rregullit teknik “Për instrumentet matëse”, për disa ndryshime në Vendimin nr.1351, datë 3.10.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për kërkesat dhe metrologjike për instrumentet matëse, ligjërisht të kontrolluara”;
- VKM nr. 1056, datë 23.12.2015, “Për miratimin e rregullit teknik “Për sigurinë e ashensorëve në përdorim”, i ndryshuar;
- VKM nr.1058, datë 23.12.2015, "Për miratimin e rregullit teknik "Mbi emrat e fibrave tekstile dhe etiketimi e markimi përkatës i përbërjes së fibrave të produkteve tekstile";
- VKM nr. 221, datë 28.03.2012, Për miratimin e rregullave teknike “Për etiketimin e produkteve të qelqit kristal”;
- VKM nr. 222, datë 28.03.2012, "Për miratimin e rregullave teknike për etiketimin e materialeve që përdoren në përbërësit kryesorë të veshjeve të këmbës, në shitje për konsumatorët”;
- VKM nr. 262, datë 03.04.2013, “Për miratimin e rregullit teknik “Për sigurinë e lodrave”;
- Urdhri nr. 25, datë 10.08.2018, Për Miratimin e Rregullores për Përcaktimin e Procedurës së Inspektimeve, si një Proces i Rregullt Administrativ”;
- Akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

## **MBIKËQYRJA E VEPRIMTARISË SË INSPEKTIMIT**

**ISHMT**, planifikon dhe bashkërendon veprimtarinë e inspektimit, siguron unifikimin e praktikave të mbikëqyrjes të tregut dhe të inspektimit, në fushën përkatëse të përgjegjësisë, siguron cilësinë dhe efektivitetin e veprimtarisë që realizon, si dhe informon publikun për veprimtarinë e realizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për periudhën Janar – Dhjetor 2021, ISHMT ka gjeneruar *3140 inspektime gjithsej*, ku prej të cilave:

- ✓ 1723 inspektime të mbyllura<sup>2</sup> (të realizuara) prej të cilave 1405 inspektime janë të programuara dhe 318 jashtë programit;
- ✓ 986 inspektime të anuluar, prej të cilave 913 inspektime të programuara dhe 73 jashtë programit;<sup>3</sup>
- ✓ 431 inspektime në progres,<sup>4</sup> prej të cilave 418 inspektime të programuara dhe 13 jashtë programit.
- ✓ 267 inspektime me status “hapur”, prej të cilave 265 inspektime të programuara dhe 5 jashtë programit.

Më poshtë pasqyrohet numri i inspektimeve të programuara dhe jashtë programit, për çdo muaj, si dhe raporti në përqindje të inspektimeve të programuara dhe jashtë programit.


Muaji	Numri i Inspektimeve të realizuara (statusi: mbyllur)		Numri i Inspektimeve në progres		Numri i Inspektimeve të anuluar	
	Të programuara	Jashtë programit	Të programuara	Jashtë programit	Të programuara	Jashtë programit
Janar	58	37	-	-	130	22
Shkurt	125	37	1	-	179	14
Mars	28	3	1	-	203	-
Prill	-	2	-	-	-	-
Maj	154	54	18	-	42	10
Qershor	169	53	66	1	33	6
Korrik	197	50	20	1	126	7

<sup>2</sup> Të dhënat janë gjeneruar nga moduli i çështjes, me anë të filtrave “hapur nga” dhe “mbyllur deri”, për periudhën nga 04.01-31.12.2021

<sup>3</sup> Konstatohet një rritje e numrit të çështjeve të anuluar, krahasuar me vitin 2020

<sup>4</sup> Të dhënat janë gjeneruar nga moduli i çështjes, me anë të filtrave “hapur nga” dhe “hapur deri”, për periudhën nga 04.01-31.12.2021

Gusht	160	11	12	-	55	8
Shtator	116	19	19	-	117	3
Tetor	161	13	126	3	12	1
Nëntor	150	7	105	8	14	-
Dhjetor	87	32	50	-	2	2
<b>Totali</b>	<b>1405</b>	<b>318</b>	<b>418</b>	<b>13</b>	<b>913</b>	<b>73</b>



### **Gjetje:**

1. Konstatohet një numër i madh çështjesh të gjeneruara, të cilat janë me statusin “në progres” “anuluara” dhe “të hapur”.

**Observacion ISHMT:** Çështjet e inspektimit qëndrojnë në statusin “në progres” kur praktika e inspektimit nuk është mbyllur, pra nuk është marrë një vendim përfundimtar, kjo për shkak se inspektorët kanë lënë afat për dokumente ose për të zbatuar kërkesat ligjore. Çështjet qëndrojnë në statusin “të hapura” në rastet kur autorizimi ka dalë dhe ka rezultuar se subjekti ka qenë i mbyllur, përfaqësuesi i autorizuar ka të pamundur të paraqitet ne subjekt, subjekti nuk ishte objekt inspektimi, etj. Inspektimet të cilat nuk janë realizuar për arsye të ndryshme anulohen dhe shfaqen në sistemin “e-Inspection” si çështje në statusin “të anuluar”.

*Ky observacion nuk pranohet. Çështjet e inspektimit qëndrojnë me status “të hapur”, pasi janë programuar dhe aprovuar nga Kryeinspektori. Çështjet e inspektimit me status “në progres” qëndrojnë jo vetëm kur pritet marrja e vendimit përfundimtar i grupit të inspektimit sipas afateve, por edhe kur është gjeneruar vetëm Autorizimi. Gjetja konstaton numrin e madh të këtyre çështjeve në progres që kanë të gjeneruar vetëm autorizimin.*

2. Arsyetimi i çështjeve të anuluar, nuk është realizuar nëpërmjet një dokumentacioni justifikues, i cili argumenton në mënyrë ligjore anulimin e çështjeve.

*Observacion ISHMT: Çështjet e anuluar janë të shoqëruara nga relacioni ku shpjegohen arsyet për moskryerjen e inspektimit së bashku me dokumente justifikues si foto ose deklarata doganore ne rastet kur subjekti nuk është objekt inspektimi.*

*Ky observacion nuk pranohet. Nga mbikëqyrja e disa çështjeve konstatohet se arsyetimi i anulimit nuk është i shoqëruar nga relacioni shpjegues për arsyetimin e mos realizimit të inspektimit përkatës.*

## **II. Programimi i inspektimeve**

**Programi Vjetor** i inspektimeve është hartuar në bazë të prioriteteve dhe kategorish subjektsh të ndara sipas këtyre prioriteteve, dakordësuar nga Inspektorati Qendror dhe miratuar nga autoriteti përgjegjës.

**Programet Mujore** janë hartuar në bazë subjektsh inspektimi, me listë emërore, sipas formatit të miratuar nga Inspektorati Qendror, fusha e veprimtarisë e të cilëve lidhet me tematikën/prioritetin e programit vjetor.

### **Gjetje:**

1. Subjektet e planifikuara për t'u inspektuar sipas programeve mujore të sjella me shkresë pranë Inspektoratit Qendror, nuk përputhen me subjektet e planifikuara dhe të gjeneruara në sistem për muajt përkatës si: Janar, Shkurt, Mars, Maj, Korrik, Shtator dhe Tetor.
2. Nga mbikëqyrja e të gjitha programeve mujore në sistem, krahasuar me programet mujore të sjellë me shkresë, rezulton se numri i inspektimeve të realizuar në sistemin “e-Inspektimi”,

është më i vogël se numri i inspektimeve sipas programeve mujore të dakordësuar me shkresë pranë IQ-së.

3. Në sistemin “*e-Inspektimi*”, konstatohet një numër i madh çështjesh të planifikuara, të cilat janë me statusin “anuluara” dhe “në progres”, duke mos realizuar programin e dakordësuar nga Inspektorati Qendror.

### III. Mbikëqyrja online e dokumentacionit për kryerjen e veprimtarisë inspektuese

Veprimtaria inspektuese është realizuar nëpërmjet dokumentacionit standard: Autorizim, Listë Verifikimet, Procesverbal Inspektimi, Vendim i Ndërmjetëm dhe Vendim Përfundimtar.

#### ➤ **Autorizimi i Inspektimit dhe Listë Verifikimi**

#### **Gjetje:**

*1. Autorizimi i inspektimit nuk është njoftuar paraprakisht për të gjitha çështjet e mbikëqyrura të inspektimit. .*

(Autorizimi nr. ISHMT-DQ-2021-000987-1; ISHMT-DQ-2021-001413-1; ISHMT-DQ-2021-002284-1; ISHMT-DQ-2021-002644-1; ISHMT-DQ-2021-000125-1...etj)

*2. Formati Listë Verifikim nuk plotësohet në të gjitha rubrikat e tij, për të gjitha kërkesat ligjore të parashikuara në të.*

(Listë Verifikimi nr. ISHMT-DQ-2021-000402; ISHMT-DQ-2021-000969; ISHMT-DQ-2021-001182; ISHMT-DQ-2021-001406; ISHMT-DQ-2021-002964;...etj )

**Observacion ISHMT:** *Lista e verifikimit plotësohet nga inspektorët sipas objektit të përcaktuar në autorizim. Brenda të njëjtit autorizim mund të ketë klasifikime të ndryshme për produktet dhe për këtë arsye lista e verifikimit shihet e paplotësuar.*

**Ky observacion pranohet pjesërisht.** *Për ato kërkesa ligjore të listë verifikimit, të cilat zbatimi i*

tyre nuk i përket një kategorie të caktuar produkti, grupi inspektimit të pasqyrojë në kolonën “komente” informacionin që kërkesa ligjore “nuk është e aplikueshme”, rast pas rasti, në përputhje me objektin e përcaktuar në Autorizim.

## ➤ **Procesverbali i Inspektimit**

### **Gjetje:**

1. *Veprimtaria inspektuese në subjekt është realizuar jashtë afateve të përcaktuar në autorizimin e lëshuar.*

(Autorizimi nr. ISHMT-DQ-2021-001323-1, datë 28.06.2021, Listë Verifikimi nr. ISHMT-DQ-2021-001323-2/1 dhe 2/2, datë 04.07.2021 dhe Procesverbal Inspektimi nr. ISHMT-DQ-2021-001323-2, datë 04.07.2021; Autorizimi nr. ISHMT-DQ-2021-001547-1, datë 04.07.2021 dhe Procesverbal Inspektimi nr. ISHMT-DQ-2021-001547-2, datë 08.07.2021;...etj)

2. *Konstatohen pasaktësi në plotësimin e datës/kohëzgjatjes së zhvillimit të inspektimit në procesverbalin e inspektimit.*

(Procesverbal Inspektimi nr. ISHMT-DQ-2020-002909-2, datë 19.01.2021; ISHMT-DQ-2021-000215-2, datë 09.02.2021; ISHMT-DQ-2021-001659-2, datë 30.06.2021; ISHMT-DQ-2021-001967-2, datë 04.08.2021; ISHMT-DQ-2021-001992-2, datë 12.08.2021;...etj)

**Observacion ISHMT:** .....Inspektorët nuk kanë qenë të informuar për detyrimin e plotësimin të kohëzgjatjes së inspektimit. Plotësimi gabim në sistem i datës së mbarimit të inspektimit ka qenë një gabim njerëzor, pasi siç shikohet në procesverbal data e fillimit të tij është në rregull, gjithashtu dhe ora e fillimit e mbarimit janë në rregull.

**Ky observacion nuk pranohet.** Kjo gjetje është konstatuar nga IQ edhe në Raportin e Mbikëqyrjes së ushtruar për vitin 2020, si dhe është lënë rekomandim për përmirësim. Gabimet njerëzore mirëkuptohen, por të merren masat për minimizimin e këtyre gabimeve sa më shumë të jetë e



*mundur.*

*3. Procesverbali, në rubrikën “gjetjet e konstatuara”, nuk pasqyron në mënyrë të detajuar konstatimet/shkeljet në subjektin e inspektuar nga ana e inspektorëve.*

(Procesverbali nr. ISHMT-DQ-2021-000249-2; ISHMT-DQ-2021-000366-2; ISHMT-DQ-2021-000129-2; ISHMT-DQ-2021-000124-2; ISHMT-DQ-2021-000969-2; ISHMT-DQ-2021-001659-2;...etj)

*Observacion ISHMT: ...Rubrika gjetje të konstatuara plotësohet vetëm me specifikimet e ligjit që shkelet dhe nuk të lejon të plotësohet me të dhëna të tjera. Inspektorët plotësojnë përshkrimin e detajuar në rubrikën koment në procesverbal e cila nuk shfaqet në procesverbalin e gjeneruar. Gjithashtu, në disa raste produktet e konstatuara nuk detajohen në procesverbal, por i bashkëlidhen praktikës në protokoll dhe ngarkohen në sistemin “e-Inspection”.*

*Ky observacion nuk pranohet. Nga testimi në ambientin “test”, vërehet se tek rubrika “gjetje të konstatuara”, në procesverbalin e inspektimit, përveç specifikimit të ligjit të shkelur, është hapësira edhe për komente, e cila shfaqet në proces verbal e gjeneruar, ku inspektori përshkruan/detajon gjetjet në vendin e inspektimit.*

## ➤ **Vendimi Përfundimtar**

### **Gjetje:**

*1. Vendimi përfundimtar është marrë jashtë afateve të përcaktuar në ligjin për inspektimin, duke tejkaluar 30 ditë nga njoftimi i procesverbalit të inspektimit subjektit të inspektimit.*

(Çështja nr. ISHMT-DQ-2021-001113: Procesverbali i Inspektimit nr. ISHMT-DQ-2021-001113-2, datë 24.06.2021 dhe Vendim Përfundimtar nr. ISHMT-DQ-2021-001113-5, datë 26.07.2021;)

➤ **Mbikëqyrje e moduleve në sistemin “e-Inspektimi”<sup>5</sup>**

**Gjetje:**

1. Në të gjitha rastet e mbikëqyrura, në sistem nuk gjendet dokumenti “denoncim apo informacioni nga të tretë” për çështjet jashtë programit, dhe as dokumenti “kthim përgjigjeje”, për informimin e rezultatit në përfundim të procedimit të inspektimit, personit që ka paraqitur denoncimin.

**Observacion ISHMT:** Të gjitha ankesat mbi bazë të të cilave bëhet inspektimi i paplanifikuar janë të protokolluara dhe nr. prot., të ankesës si dhe arsyeja e denoncimit vendoset në autorizim, ndërsa uploadimi i ankesës në sistem nuk është kryer plotësisht në 2021, por duke filluar nga 2022, çdo ankesë hidhet në sistem.

**Ky observacion nuk pranohet.** Nga çështjet e mbikëqyrura nuk rezulton që ankesa e protokolluar të jetë uploaduar në sistem. Në vazhdimësi grupi inspektimit të procedojë me uploadimin në sistem të ankesës si dhe kthimin e përgjigjes ankimesit nëse ka.

2. Ka raste kur në sistem nuk gjenden të ngarkuara dokumente të sjella nga subjekti, për të cilat justifikohet heqja e shkeljeve të konstatuara në procesverbalin e inspektimit.

**Observacion ISHMT:** Dokumentet e sjella nga subjekti, të cilat justifikojnë heqjen e shkeljes protokollohen dhe i bashkëlidhen praktikës së inspektimit në protokoll.


**Ky observacion nuk pranohet.** ISHMT të marrë masa për administrimin e dokumentacionit të sjellë nga subjekti edhe në sistemin “e-Inspektimi”, si pjesë e procedimit të inspektimit.

3. Në sistem nuk gjenden të ngarkuara dokumente justifikuese (foto/video), të marra gjatë procesit inspektues, për pjesën më të madhe të dosjeve të mbikëqyrura.

<sup>5</sup> Nuk janë sjellë shembuj çështjesh pasi janë gjetje të konstatuara në pothuajse shumicën e dosjeve të mbikëqyrura

#### IV. Masat Administrative

- Për periudhën Janar-Dhjetor 2021, ISHMT ka marrë gjithsej 127 *masa administrative, gjobë*, si pasqyrohet edhe në grafikun e mëposhtëm. Të dhënat janë gjeneruar nga moduli “Skeduli i Çështjeve”, në sistemin “e-Inspektimi”<sup>6</sup>.



#### Gjetje:

1. Në modulën “gjobat”, nuk pasqyrohet ecuria e masës administrative (ankimuar ose jo, papaguar/paguar, data e pagesës dhe kësti).

<sup>6</sup> Numri i gjobave mund të mos jetë i saktë si pasojë e nxjerrjes së kësaj statistike nga moduli “Skeduli i Çështjeve” dhe jo nga moduli “Raporte”

## KONKLUSIONE

Për sa trajtuam më sipër konkludojmë se:

- ISHMT realizon veprimtarinë inspektuese në zbatim të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, "Për Inspektimet në Republikën e Shqipërisë", si dhe ligjeve sektoriale.
- Veprimtaria inspektuese e ISHMT mbështetet në Programin Vjetor të hartuar dhe miratuar nga autoriteti përgjegjës, në zbatim të pikës 1, të Kreut IV, të VKM nr. 696, datë 16.08.2013, "Për Përcaktimin e Procedurave të Ushtrimit të Kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të Rregullave për Përmbajtjen dhe Administrimin e Portalit Unik "e-Inspektimi".
- Programet Mujore të ISHMT janë sjellë për mendim pranë Inspektoratit Qendror, në zbatim të Kreut IV, të VKM nr. 696, datë 16.08.2013, "Për Përcaktimin e Procedurave të Ushtrimit të Kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të Rregullave për Përmbajtjen dhe Administrimin e Portalit Unik "e-Inspektimi".
- Nga mbikëqyrja konstatohet mospërputhje të subjekteve të planifikuara për t'u inspektuar sipas programeve mujore të sjella me shkresë pranë Inspektoratit Qendror, me subjektet e planifikuara dhe të gjeneruara në sistem për muajt përkatës. Gjithashtu, numri i inspektimeve të realizuar në sistemin "e-Inspektimi", është më i vogël se numri i inspektimeve sipas programeve mujore të dakordësuar me shkresë pranë IQ-së.
- Dokumentet e veprimtarisë inspektuese të gjeneruara në sistem nuk janë të nënshkruara nga kryeinspektori, inspektorët apo subjekti i inspektimit, duke qenë se veprimtaria inspektuese e inspektorëve të ISHMT, vazhdon të realizohet nëpërmjet laptop-eve dhe jo tabletave.
- Dokumenti "Autorizim", për inspektimet e programuara, nuk njoftohet paraprakisht 3 ditë para fillimit të inspektimit. Mos njoftimi paraprak i inspektimit nuk mund të motivohet për të gjitha inspektimet sipas shkronjës "a" të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, "Për inspektimet në Republikën e Shqipërisë".
- Ka raste kur veprimtaria inspektuese në subjekt është realizuar jashtë afateve të përcaktuara në autorizimin e lëshuar.
- Dokumentet "Listë Verifikim" dhe "Procesverbal" nuk plotësohen në tërësinë e tyre, duke mos zbatuar nenin 45, ligjit nr. 10 433, datë 16.6.2011, "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

- Dokumenti “Procesverbal” ka pasaktësi në plotësimin e rubrikës “kohëzgjatja e inspektimi” lidhur me datën e zhvillimit të inspektimit apo kohëzgjatjen e inspektimit në orë.
- Në sistemin “*e-Inspektimi*”, për pjesën më të madhe të dosjeve të mbikëqyrura, nuk gjenden të ngarkuara dokumentet “denoncim apo informacioni nga të tretë”, apo edhe dokumentacione të tjera justifikuese marrë gjatë procesit të inspektimit ose sjellë nga subjekti.
- Në modulën “gjobat”, nuk pasqyrohet ecuria e masës administrative (ankimuar ose jo, papaguar/paguar, data e pagesës dhe kësti), në kundërshtim të pikës 10, të Kreut XIII, të VKM nr. 696, datë 16.08.2013, “Për Përcaktimin e Procedurave të Ushtrimit të Kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të Rregullave për Përbajtjen dhe Administrimin e Portalit Unik “*e-Inspektimi*”.
- Në sistemin e “*e-Inspektimi*” gjendet një numër i madh çështjesh inspektimi me statusin “në progres”, “të anuluar” dhe “të hapura”, të cilat janë të programuara.

## REKOMANDIME

Për zgjidhjen e problematikave të hasura, mangësive apo parregullsive, si dhe për të përmirësuar veprimtarinë inspektuese të ISHMT-së, që ato të ndreqen dhe të mos përsëriten në të ardhmen, *ju sjellim në vëmendje* rekomandimet sa më poshtë vijon:

- Trupa inspektuese e ISHMT-së, të përdorë tabletat për realizimin e veprimtarisë inspektuese, në mënyrë të tillë që dokumentet e gjeneruara në sistem të jenë të nënshkruara nga kryeinspektori, inspektorët dhe subjekti i inspektimit, si dhe të bëhet e mundur gjurmimi i vendit të inspektimit nëpërmjet sistemit të gjurmueshmërisë.
- Subjektet e programuara të sjella me shkresë pranë Inspektoratit Qendror, të përputhen me subjektet e programuara dhe gjeneruara në sistemin “e-Inspektimi”, sipas muajve përkatës.
- ISHMT, të realizojë numrin e inspektimeve të programuara sipas programeve mujore të dakordësuara me shkresë pranë IQ-së.
- ISHMT, të realizojë inspektimet e programuara dhe të minimizojë numrin e çështjeve me status “në progres” dhe “të hapur”.
- ISHMT, të marrë masa për argumentimin në mënyrë ligjore të çështjeve me status “anuluar”, me anë të dokumentacionit të nënshkruar nga Kryeinspektori dhe dokumentacion plotësues justifikues (foto).
- ISHMT, të njoftojë subjektin për inspektimin e programuar, jo më vonë se 3 ditë përpara fillimit të veprimeve të inspektimit, si dhe të ngarkojë në sistem dokumentin e njoftimit, në zbatim të pikës 1, të nenit 32, të ligjit për inspektimin.
- Trupa inspektuese, të realizojë veprimtarinë inspektuese në subjekt sipas afateve të përcaktuara në autorizimin e lëshuar, në zbatim të nenit 29, të ligjit për inspektimin, pasi çdo veprim procedural i kryer jashtë kohëzgjatjes së përcaktuar në autorizim nuk prodhon asnjë pasojë juridike për subjektin e inspektimit dhe ngarkon me përgjegjësi disiplinore inspektorin përkatës.
- Trupa inspektuese, të plotësojnë të gjitha rubrikat dhe në mënyrë të saktë të listë-verifikimeve, për të gjitha kërkesat ligjore të parashikuara në të.



- Trupa inspektuese të plotësojë saktë datën/kohëzgjatjen e zhvillimit të inspektimit në procesverbalin e inspektimit.
- Procesverbali duhet të përmbajë informacione të hollësishme për veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit, në zbatim të pikës 3 të nenit 45 të ligjit për inspektimin.
- Vendimi Përfundimtar i inspektimit merret nga inspektori apo inspektorët që kanë kryer inspektimin, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të procesverbalit subjektit të inspektimit, në zbatim të nenit 46, të ligjit për inspektimin.
- Të ngarkohet në sistemin “*e-Inspektimi*” dokumenti “denoncim apo informacioni nga të tretë” dhe dokumenti “kthim përgjigjeje” për informimin e rezultatit në përfundim të procedimit të inspektimit, personit që ka paraqitur denoncimin, në zbatim të pikës 3, të nenit 25, të ligjit për inspektimin.
- Në sistemin “*e-Inspektimi*” të ngarkohen dokumentet e sjella nga subjekti, për të cilat justifikohet heqja e shkeljeve të konstatuara në procesverbalin e inspektimit.
- Veprimtaria inspektuese të dokumentohet edhe me dokumente justifikuese, si foto/video, të cilat të ngarkohen në sistemin “*e-Inspektimi*”.
- Në zbatim të pikës 10, të Kreut XIII, të VKM nr. 696, datë 16.08.2013, “Për Përcaktimin e Procedurave të Ushtrimit të Kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të Rregullave për Përmbajtjen dhe Administrimin e Portalit Unik “*e-Inspektimi*”, të pasqyrohet ecuria e masës administrative (ankimuar ose jo, papaguar/paguar, data e pagesës dhe kësti), në modulën “gjyba”.

## **REALIZIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NGA MBIKËQYRJA E MËPARSHME JANAR-DHJETOR 2020**

1. *Trupa inspektuese e ISHMT-së, të përdorë tabletat për realizimin e veprimtarisë inspektuese, në mënyrë të tillë që dokumentet e gjeneruara në sistem të jenë të nënshkruara nga kryeinspektori, inspektorët dhe subjekti i inspektimit, si dhe të behet e mundur gjurmimi i vendit të inspektimit nëpërmjet sistemit të gjurmueshmërisë.*

**Ky rekomandim, edhe përgjatë vitit 2021 nuk është realizuar** nga trupa inspektuese e ISHMT-së. Dokumentet e veprimtarisë inspektuese në sistemin “e-Inspektimi” nuk janë të nënshkruara nga palët pjesëmarrëse në inspektim, pasi procedura e inspektimit nuk realizohet me tablet.

2. *Lista e subjekteve të programuara në sistemin “e-Inspektimi”, të jetë e njëjtë me listën e subjekteve sjellë me shkresë pranë Inspektoratit Qendror.*

**Ky rekomandim është përmirësuar pjesërisht**, por përsëri ka subjekte të cilat janë programuar dhe janë sjellë me shkresë pranë IQ-së, por nuk janë inspektuar gjatë muajit të planifikuar.

3. *ISHMT, të njoftojë subjektin për inspektimin e programuar, jo më vonë se 7 ditë para fillimit të inspektimit, si dhe të ngarkojë në sistem dokumentin e njoftimit.*

**Ky rekomandim është përkeqësuar**, pasi nga dosjet e inspektimit të mbikëqyrura, inspektimet e programuara, të gjitha ishin pa njoftim.

4. *ISHMT, të plotësojë të gjitha rubrikat dhe në mënyrë të saktë, të listë-verifikimit, procesverbalit të inspektimit dhe vendimit përfundimtar.*

**Ky rekomandim është përmirësuar pjesërisht**, pasi ka raste ku dokumentet standarde plotësohen në mënyrë të pasaktë.

5. *Në zbatim të pikës 3 të nenit 45 të ligjit për inspektimin, procesverbali duhet të përmbajë informacione të hollësishme për veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit.*

**Ky rekomandim është përmirësuar**, por evidentohen edhe dosje ku nuk detajohen veprimet e inspektimit në subjekt, si dhe konstatimet e hollësishme për shkeljet e gjetura.

6. *Në zbatim të ligjit për inspektimin, vendimi përfundimtar, të përmbajë informacion lidhur me përmbushjen e detyrimit të subjektit apo argumentimin për heqjen e shkeljeve të konstatuara*

*në procesverbal gjatë inspektimit.*

